



Nr. 27/4 Prot.
Tiranë, më 16 Mars 2023

Lënda: Dërgohen të dhënat e kërkuara sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 64 të ligjit nr. 10019/2008 sipas Vendimit me Nr.27 datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ-së.

Drejtuar: Z. Ilirjan Celibashi
Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
TIRANË

I nderuar z. Komisioner,

Në zbatim të Vendimit me Nr.27 datë 16.03.2023 të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve – KAS dhe në përputhje me pikën 2 të nenit 64 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ku specifikohet se: “2. Për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor për çdo lloj zgjedhjeje, një parti politike duhet të paraqesë në KQZ: ...b) emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është personi i autorizuar për të paraqitur kandidatët; c) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë; ç) specimenin e vulës së partisë; d) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë; dhe dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në”, lutemi gjeni më poshtë të dhënat përkatëse:

1. Kryetari i Komanduar i PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË, **Z.ENKELEJD ALIBEAJ**, me adresë Rr. Donika Kastrioti, Nr. 3, Hyrja 1, Tiranë.

Me respekt,

Indrit SEFA
Sekretar për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore
Partia Demokratike e Shqipërisë

Indrit Sefa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

DEKLARATA E ANGAZHIMIT SOLEMN E KRYETARIT TË PARTISË POLITIKE

Zgjedhje për Organet e Qeverisjes Vendore

Data e zgjedhjeve

14/05/2023

I) TË DHËNAT E
KRYETARIT

Partia Demokratike e Shqipërisë

PD

Rr. Donika Kastrioti, Tiranë

Partia (emri zyrtar i partisë)

(shkronjat nistore)

(Adresa e partisë)

Kryetari i komanduar partisë z

Enkelejd Lutfi Alibeaj

(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të komanduar partisë)

DEKLAROJ NË CILËSINË E KRYETARIT TË KOMANDUAR TË PARTISË:

Angazhimin solemn të Partisë tonë se, pjesëtarët e strukturave drejtuese dhe administrative, të anëtarësisë, kandidatëve për deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore, deputetë/ drejtues/ anëtarë të organeve të qeverisjes vendore dhe gjithë strukturave të tjera të angazhuara nga subjekti në këto zgjedhje, funksionarë/ ish funksionarë publik do të refuzojnë të marrin pjesë në praktikën e blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale.

Angazhohemi të zbatojmë rregulla për të gjithë anëtarësinë, administratën dhe ndjekësit tanë që: Të mos premtojnë/ ofrojnë/ japin para, mallra, shërbime dhe/ose nxisin premtime për punësim apo trajtime të tjera të veçanta votuesve dhe/ose të tjerëve, duke përfshirë familjet e votuesve apo komuniteteve të ndryshme apo të veprojnë në mënyrë të tillë që synohet të ndikojë, ose arsyeshëm pritët të ndikojë në mënyrën se si votuesit japin votën e tyre;

- Të zbatojmë parimet bazë të trashëgimisë zgjedhore europiane për votim universal, të barabartë, të lirë, të fshehtë, dhe të drejtpërdrejtë;
- Të respektojmë të drejtat dhe liritë politike të shtetasve, organizatave, partive politike, për të promovuar dhe debatuar çështje politike;
- Të mos përfshihemi në praktika kërcënuese ose pengimi për të ushtruar të drejtën e votës dhe shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve.
- Të bëjmë publike në kohë reale pranë KQZ-së dhe faqen zyrtare të subjektit tonë politik çfarëdolloj donacioni si dhe të refuzojmë dhurime në mjete monetare apo në natyrë që:

-Tejkalojnë limitin e përcaktuar për donacion;

-Janë kontribute në para apo në natyrë me prejardhje nga burime të ndaluara që përfshijnë edhe të ardhurat nga krimi, individë, kompani të huaja nga vende me origjinë të dyshimtë/të parajsave fiskale;

-Janë donacione të cilat nënkuptojnë apo perceptohen si favorizime për dhënie kontrata publike, emërimë në funksione publike apo përfitime të tjera që shkojnë në emër e për llogari të dhuruesit.

Kryetari i Komanduar i Partisë

ENKELEJD LUTFI ALIBEAJ

(emër, atësi, mbiemër i kryetarit të komanduar të partisë) (nënshkrimi)

16/03/2023

(data dd/mm/vvvv)

